



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

**VENDIM
Nr. 64, datë 27.07.2009**

**PËR
MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË SIGURIMIT
INSIG SH.A**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 23 të Ligji nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Pas inspektimit të kryer pranë shoqërisë “Insig” sh.a dhe analizës së gjendjes financiare të vitit 2008 dhe 3 mujorit të parë të vitit 2009, rezultoi se shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozita të caktuara të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”. Shoqëria është vënë në dijeni të shkeljeve të konstatuara si nga raporti përfundimtar i inspektimit (pas pasqyrimit dhe të observacioneve të shoqërisë) ashtu edhe nëpërmjet takimeve zyrtare të kryera nga Autoriteti me përfaqësues të shoqërisë. Për sa më sipër Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Të urdhërojë shoqërinë e sigurimit “Insig” sh.a, bazuar në nenin 124, pika 1, gërma ë) dhe nenit 125, pika 1, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004:
 - a) të marrë masa për eliminimin e shkeljeve të nenit 103 të Ligjit nr.9267, datë 29.07.2004, në lidhje me investimin e aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike;
 - b) të marrë masa për eliminimin e shkeljeve të rregullave të menaxhimit të rrezikut për shitje të kontratave të Kartonit Jeshil mjeteve të rregjistruara në Kosovë, parashikuar nga neni 107 dhe 108, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004;
 - c) të paraqesë në Autoritet brenda datës 31.08.2009, një raport të detajuar për masat e marra për eliminimin e shkeljeve të mësipërme.

2. Të urdhërojë që, brenda datës 30.09.2009, shoqëria të depozitojë në Autoritet, Raportin e Kontrollit të Brendshëm në përputhje me kërkesat e neneve 69 dhe 70, të Ligjit nr.9267, datë 29.07.2004.
3. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI